
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>Zyra e Personelit</b> <b>Kancelarija za Osoblje</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.116/18	Datë: 05.07.2018	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës , Komuna e Istogut shpall :

## KONKURS

### Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Drejtoria:** Drejtoria për Inspektion

**Vendi i punës :** Inspektor i Komunikacionit

**Lloji i pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta ( kohëzgjatja 5 muaj, me mundësi vazhdimi )

**Numri i ekzekutuesve:** 1 (një)

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Paga:** 400 euro

#### **Detyrat dhe përgjegjësit:**

- Inspektimin dhe kontrollimin e operatoreve të transportit rrugor të udhëtareve brenda territorit të komunës (autobusët, auto taksit), se a janë duke e ushtruar veprimtarinë në pajtim me dispozitat e parapara me Rregulloren komunale për transport, në bazë të licencave, lejeve dhe rendit të udhëtimit,
- Të kontrollojë apo mbikëqyrë detyrimet e operatoreve transportues të udhëtareve (autobusëve), se a janë duke e shfrytëzuar stacionin e autobusëve në Istog për parking dhe pastaj fillimin e linjës së caktuar nga aty dhe vend ndaljet tjera të caktuara me sinjalizim horizontal dhe vertikal,
- Të urdhërojë mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me rregullore për kryerjen e transportit të udhëtareve,
- Të përjashtojë apo të ndalojë përkohësisht operatorin apo personin fizik nga qarkullimi automjetin me të cilën kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe rregullores në fuqi,
- Bënë iniciimin e procedurës në gjykatën kompetente përkatëse, kur konstatohet se operatori i transportit rrugor të udhëtareve, gjegjësisht operatori juridik apo fizik për auto taksit, kanë vepruar në kundërshtim me rregulloren në fuqi,
- Është përgjegjës për punën e vet që bënë në teren, e po ashtu gjatë përpilimit të shkresave të ndryshme administrative,
- Në bazë të kërkesës së eprorit përpilon planet javore, mujore dhe vjetore operative të punës,
- Kryen edhe punë të tjera shtesë kur kërkohet nga udhëheqësi i tij,

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kane shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Dokumentet:**

- Dëshmi të kualifikimi shkollor: primar fakulteti i komunikacionit, në mungesë të këtij kualifikimi të drejt konkurrimi kanë edhe ata me përgatitje si të fakultetit juridik, ekonomik etj. ;
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

**Afati i konkursit :** Afati i aplikimit është 8 ditë, nga shpallja publike në tabelën e shpalljeve dhe në Web faqe të Komunës.

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë "*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



**Menaxheri i Personelit**  
**Fatmir Bytyçi**